RUKIE-KURIM ME KURAN
DHE LUTJE PROFETIKE

Titulli i librit:

RUKJE-KURIM ME KURAN DHE LUTJE PROFETIKE

الرقية الشرعية بالقرآن والسنة

Përpiloi:

Altin Torba

©Çdo ribotim i plotë ose i pjesshëm i këtij libri është i lejuar vetëm për qëllime jofitimprurëse.

Publikimi i parë: Prill 2020

Ju ftojmë ta shpërndani këtë publikim, që të përhapet dobia e tij dhe së bashku të marrim shpërblimin e publikuesit të fjalës së mirë.

Rruga e shërimit nga magjia, mësyshi etj. është e mundur – Falënderuar qoftë Allahu! Faktikisht Allahu i Madhëruar, për çdo sëmundje të zbritur, ka zbritur edhe shërimin, fakt ky që është pohuar nga Profeti (Lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të!)!

Parathënie

Kush e bën rukjen sheriatike[1] dhe kujt i bëhet ajo[2].

Bërja e rukjes sheriatike (sipas normave islame) konsiderohet një vepër fetarisht e pëlqyeshme dhe rrjedhimisht e dobishme. Atë lejohet ta bëjë muslimani që bart një bindje të saktë islame dhe mund të bëhet për çdo lloj sëmundje[3]. Rukja mund t'i bëhet edhe jomuslimanit, si dhe mund t'i bëhet edhe një personi që është shëndosh e mirë (i paprekur nga magjia, mësyshi dhe ngjashëm). Ajo përbën një kurim në përputhje me normat islame, të cilin robi e përdor si mbrojtje nga problemet dhe të këqijat fizike, shpirtërore dhe ato djallëzore.

Tekstet sheriatike islame lënë të kuptohet se nuk është kusht që hollësirat e rukjes së lejuar sipas islamit, të referohen njëpërnjë në transmetime të posaçme hyjnore islame, porse që rukja të jetë e lejuar mjafton që ajo të mos bjerë në kundështim me normat ligjore islame. Shumë dijetarë muslimanë janë të mendimit se nuk ka asnjë problem të lexohen ajete kuranore të veçanta që është provuar se sjellin sukses në rukje (kurimin me Kuran dhe lutje islame) dhe që këto ajete t'u mësohen njerëzve për t'i përdorur; bazuar kjo në transmetimin autentik profetik miratues të bërjes së rukjes përmes leximit të sures (kaptinës kuranore) El-Fatiha[4].

Së këtejmi, çdo musliman/e me bindje të saktë islame, që di t'i lexojë (sidomos është mirë edhe t'i kuptojë) në arabisht Kuranin dhe Lutjet Profetike, mund t'i bëjë rukje sheriatike me to (Kuran dhe Lutjet Profetike) ose edhe me lutje me përmbajte të lejuar islame[5] vetes së tij/saj dhe çdo personi të prekur nga magjia, mësyshi dhe ngjashëm. Kurse rukja në gjuhë tjetër veç arabishtes është e papëlqyeshme (dhe sipas disa mendimeve të tjera është e ndaluar), teksa mendimi më i fuqishëm është se ajo (rukja jo në arabisht) lejohet të bëhet nëse bërësi i saj: (së pari) është musliman me bindje të saktë islame, (së dyti) nuk di arabisht, (së treti) lutet me lutje në përputhje me normat islame dhe (së katërti) lutjet e bëra janë të kuptueshme për të pranishmit[6].

Edhe pse si rregull rukja mund të bëhet nga çdo musliman/e, në rastin kur bërësi i rukjes bie në situata ku gjendja e kujt po i bën rukje komplikohet dhe i mungon përvoja për këtë situatë, (në këtë rast) rukja ndërpritet dhe vijohet pasi personi të cilit i bëhet rukje të jetë qetësuar; por nëse situata e komplikuar përsëritet apo ndërlikohet më tej, rukja duhet vijuar nga persona me eksperiencë në lëmin e saj.

---

[1] Rukje sheriatike: Kurim me formula mbrojtëse të foluri dhe vepruari, brenda normave ligjore islame.
[2] Shih: islamweb, islamqa, alukah dhe islamweb.
[3] Këtu nënkuptohet se rukja lejohet të bëhet si për personin që vuan nga sëmundje shpirtërore / mendore, të tilla si: magjia, mësyshi, çrregullimet mendore dhe ato të pasionit etj.; ashtu edhe për atë që vuan nga sëmundjet fiziologjike apo trupore.
[4] Transmetim nga El-Bukhari 5736 dhe Muslimi 2201.
[5] Shih: islamweb.
[6] Shih: islamway dhe islamweb.

Kur bëhet rukja

Në realitet rukja është lutje dhe aspirim i të mirës prej Allahut të Madhëruar dhe lejohet të bëhet në çdo kohë, teksa nëse ajo bëhet në kohët e ditura të pranimit të duasë (lutjes) kjo është sërish shumë mirë.[7]

Po kështu, bazuar në normat islame, nuk është se ka ndonjë kohë të caktuar në të cilën rukja ka sukses, por, nëse është e nevojshme, rukja, pirja e ujit të kënduar me Kuran dhe larja me këtë ujë mund të bëhet një, dy apo më shumë herë/ditë.

Sa herë lexohet rukja

Sa i përket faktit se sa herë lexohen suret apo ajetet kuranore, nuk është se ka ndonjë përzgjedhje suresh / ajetesh apo numër fiks të leximit të tyre, por ajo që thuhet në përgjithësi është se rukjet (lutjet) që bëhen bazuar në transmetimet profetike përkatëse lipset t'i përmbahen formës së ardhur në këto transmetime, kurse rukjet e përgjithshme nuk është se duhen bërë në një formë strikte të caktuar, porse bëhen nga muslimani/ja kompetent në lëmin e rukjeve, ose nga çdo musliman/e që ndjek forma të rukjes të bazuara kryesisht në eksperiencën e suksesshme të kompetentëve në lëmin e rukjes, qoftë edhe në numrin në të cilin këta kompetentë i lexojnë suret dhe ajetet e rukjes.

Pikërisht në këtë kontekst, dijetarë të shumtë muslimanë theksojnë se nuk ka asnjë problem që të lexohen ajete kuranore të veçanta që është provuar të sjellin sukses në rukje dhe se nëse bërësi i rukjes vërteton arritjen e suksesit të saj përmes përsëritjes së ajetit, sures apo rukjes në një numër të caktuar, nuk ka problem që të veprohet kësisoj, por me kushtin që të mos ushqehet bindja se ky lexim me këtë numër fiks është traditë profetike që s'bën të shtohet apo pakësohet.

[7] Referohu tek linku: **KUSHTET E PRANIMIT TË LUTJES**.

Muslimani e ka të ndaluar që të shkojë tek magjistarët, fallxhorët, sharlatanët, rrengshorët dhe njerëzit e tjerë të ngjashëm me këta, përveçse kur i ka kapacitetet për t'i demaskuar ata dhe për ta ndaluar ligësinë e tyre.

Pikërisht për të sjellë alternativën e drejtë mbi domosdoshmërinë e kurimit prej magjisë, mësyshit dhe ngjashëm përmes realiteteve dhe fakteve normative hyjnore, vjen edhe përpilimi i këtij libri, që shpresojmë të plotësojë sadopak zbrazëtinë në literaturat fetare shqipe të këtij subjekti.

Pasqyra e lëndës

Parathënie: .....f. 4.

Kush e bën rukjen sheriatike dhe kujt i bëhet ajo .....f. 4.

Kur bëhet rukja .....f. 5.

Sa herë lexohet rukja .....f. 5.

Së pari: Udhëzime të domosdoshme që duhet zbatuar .....f. 8.

Së dyti: Rukje-kurim me Kuran .....f. 11.

Së treti: Rukje-kurim me Lutje Profetike .....f. 20.

Së pari: Udhëzime të domosdoshme që duhen zbatuar

1. Largohen nga trupi i të sëmurit dhe nga shtëpia, hidhen dhe injorohen të gjitha sendet që janë marrë nga njerëz apo anë jokompetente islame, sikurse nuska, zhivë, dhé, gurë etj.

2. Bëhet mbështetja vetëm tek Allahu dhe kërkohet shërim e shpëtim vetëm nga Allahu, duke qenë të bindur se Ai do ta sjellë shërimin dhe duhet medoemos që të kihen parasysh shënimet që vijnë në fund të Rukjes[8].

3. Nëse personi nuk di arabisht dhe do që t'i lexojë ajetet dhe lutjet e sjella të transliteruara (të shkruara me gërma latine), ai obligohet që për leximin e këtij teksti rukjeje të ketë parasysh rregullat e mëposhtëm:

● Shkronja "Ă", lexohet "a" e fortë që del njëkohësisht nga kraharori dhe gurmazi;

● Shkronja "Ŭ", lexohet "u" e fortë që del njëkohësisht nga kraharori dhe gurmazi;

● Shkronja "Ĭ", lexohet "i" e fortë që del njëkohësisht nga kraharori dhe gurmazi;

● Shkronja "Ĥ", lexohet "h" e fortë që del njëkohësisht nga kraharori dhe gurmazi;

● Shkronja "Ď", lexohet "d" e fortë që del nga tingulli që përftohet nga vendosja e majës së gjuhës në zonën ku bashkohet qiellza me pjesën e brendshme të dhëmbëve të nofullës së sipërme, tingull ky që del shoqëruar me fryrjen e dy faqeve;

● Shkronja "Ť", lexohet "t" e fortë që del nga tingulli që përftohet nga vendosja e majës së gjuhës në zonën ku bashkohet qiellza me pjesën e brendshme të dhëmbëve të nofullës së sipërme, tingull ky që del shoqëruar me një fryrje të lehtë të dy mollëzave të faqes;

● Shkronja "ĎĤ", lexohet "dh" e fortë që del nga tingulli që përftohet nga vendosja e majës së gjuhës në zonën ku bashkohet qiellza me pjesën e brendshme të dhëmbëve të nofullës së sipërme, tingull ky që del shoqëruar me një fryrje të lehtë të dy mollëzave të faqes;

● Shkronja "Š", lexohet "s" e fortë që del shoqëruar me fryrjen e dy mollëzave të faqes;

● Shkronja "Ǩ", lexohet "k" e fortë që del nga zona e gjysmës së poshtme të brendisë së gojës;

● Shkronja "KH" del (lexohet) nga gjysma e poshtme e brendisë së gojës, afërsisht si tingulli që del gjatë gargarës apo kruarjes së fytit;

● Përsëritja e shkronjës, shpreh faktin se ajo duhet zgjatur pa ndërprerje; për shembull: "AA" duhet zgjatur duke mos u lexuar ndarazi "A", "A"; por duke u lexuar një "A" e vetme e zgjatur rreth 2 sekonda… kjo vlen për të gjitha rastet kur shkronja vjen e përsëritur… e njëjta gjë duhet marrë në konsideratë edhe për të gjitha rastet kur shkronjat e njëjta vijnë të ndara me vijë mesi me njëra-tjetrën; për shembull: "LL-LL".

[8] Shih: http://jetaever8.de/kurimi-i-mesyshit-e-prekjes-nga-xhindet/ dhe http://jetaever8.de/rukja-kurimi-islam-nga-magjia/.

4. Në adresën e internetit: http://faljaenamazit.com/faljaenamazit/Fillim/PasqyraELutjeve.asp mund të merren udhëzimet për pastrimin ritual dhe fletushkën e faljes.

Falja për fillestarët mund të bëhet duke lexuar nga fletushka e faljes. Obligohet leximi sa më i drejtë në arabisht i fjalëve të domosdoshme të namazit (sipas rregullave të mësipërme të transliterimit) si vijon:

● Tekbiri fillestar: **ALL-LLAAHU EKBER** (Allahu është më i madhi);

● Surja El-Fatiha lexohet siç vjen në faqen në vijim të fillimit të rukjes;

● Në ruku: **SUBĤAANE RAB-BIJEL ĂĎĤIIM** (I Patëmetë është Zoti im i Madhërishëm);

● Në ngritjen nga rukuja: **SEMIĂLL-LLAAHU LIMEN ĤAMIDEH** (Allahu e dëgjon këdo që e falënderon Atë);

● Kur drejtohemi nga ngritja prej rukusë: **RAB-BENEE UE LEKEL ĤAMD** (Zoti ynë, për Ty është falënderimi);

● Në sexhde: **SUBĤAANE RAB-BIJEL EĂLEE** (I Patëmetë është Zoti im më i Lartësuari);

● Midis dy sexhdeve: **RAB-BIGFIR LII** (Zoti im, falmë);

● Pas sexhdes së dytë të rekatit të dytë thuhet Et-Tehijati (teshehudi): **ET-TEĤIJ-JEETU LIL-LAAHI UEŤ-ŤAJ-JIBEETU, ES-SELAAMU ĂLEJKE EJ-JUHEN-NEBIJ-JU UE RAĤMETULL-LLAAHI UE BEREKEETUHU, ES-SELAAMU ĂLEJNEE UE ĂLEE ĬBAADIL-LAAHIŠ-ŠAALIĤIIN, ESH-HEDU EN LAA ILAAHE IL-LALL-LLAAH, UE ESH-HEDU EN-NE MUĤAM-MEDEN ĂBDUHU UE RESUULUH** (Përshëndetjet (madhërimet) i takojnë Allahut si dhe adhurimet (lutjet) dhe fjalët e mira. Paqja qoftë mbi ty, o Profet si dhe mëshira e Allahut dhe begatitë e Tij. Paqja qoftë mbi ne dhe mbi të gjithë robërit e mirë të Allahut. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar të meritueshëm përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij);

● Në rekatin e fundit të çdo namazi, pas sexhdes së dytë, krahas Et-Tehijatit (teshehudit) thotë edhe salavatin:

ALL-LLAAHUM-ME ŠAL-LI ĂLEE MUĤAM-MEDIN UE ĂLEE EELI MUĤAM-MEDIN KEMAA ŠAL-LEJTE ĂLEE IBRAAHIIME UE ĂLEE EELI IBRAAHIIME, IN-NEKE ĤAMIIDUN MEXHIID; UE BAARIK ĂLEE MUĤAM-MEDIN UE ĂLEE EELI MUĤAM-MEDIN KEMAA BAAREKTE ĂLEE IBRAAHIIME UE ĂLEE EELI IBRAAHIIME, IN-NEKE ĤAMIIDUN MEXHIID (O Allah! Mëshiroje Muhamedin dhe familjen e tij, ashtu sikurse e mëshirove Ibrahimin dhe familjen e tij. Me të vërtetë, Ti je i lavdëruar dhe i madhëruar. Dhe bekoje Muhamedin dhe familjen e tij, ashtu sikurse e bekove Ibrahimin dhe familjen e tij. Me të vërtetë, Ti je i lavdëruar dhe i madhëruar);

● Dhënia e selamit, edhe djathtas, edhe majtas, thuhet: **ES-SELAAMU ĂLEJKUM UE RAĤMETULL-LLAAH** (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi ju" dhe më pas nga ana e majtë, duke thënë të njëjtën shprehje).

5. Para se të lexohet rukja (kurimi me formula mbrojtëse të foluri dhe vepruari, brenda normave ligjore islame) duhet që lexuesi të pendohet, të pastrohet [të ketë gusël (larje të të gjithë trupit) dhe abdes (larje të gjymtyrëve të caktuara)], të falet namazi i

detyrueshëm dhe preferohet të këndohen lutjet ditore të mëngjesit dhe të mbrëmjes nga libri "Mburoja e muslimanit", që mund t'i merrni në linkun: https://islamhouse.com/sq/books/354804/.

6. Rukja duhet të përmbush tre kushtet në vijim:

Kushti i parë: Rukjebërësi dhe i sëmuri (të cilit i bëhet rukja), duhet të jenë të sigurtë se rukja nuk bën dobi vetvetiu (përndryshe biet në shirk / bërje shok a të ngjashëm Allahut), por bën dobi vetëm me lejen e Allahut të Madhëruar.

Kushti i dytë: Rukja të mos përmbajë shirk (idhujtari) dhe as të jetë justifikim a shkak për shirk. Të tilla janë shkeljet ligjore si: lutja e tjetërkujt veç Allahut, kërkimi i ndihmës prej xhindeve dhe shejtanëve apo ngjashëm.

Kushti i tretë: Rukja të jetë me fjalë të kuptueshme të ditura, ndërsa nuskat dhe yshtjet që përmbajnë fjalë të pakuptueshme apo misterioze nuk lejohen.

7. Duhet të bëhet kujdes që hoxha apo personi që bën Rukjen ose jep orientimet për Rukjen, të jetë njeri kompetent [me kualifikim teologjik] dhe të jetë person që nuk i kapërcen kufijtë dhe rregullat islame.

8. Lejohet Rukja e bërë në gjuhën joarabe, me kusht që teksti i saj të jetë me përmbajtje që e lejon Islami.

9. Në Rukje mund të shtohet këndimi i ajeteve dhe sureve kuranore në ujë, në një formë të tillë që pas leximit të çdo ajeti apo sureje të fryhet me cifla të padukshme pështyme mbi ujë dhe më pas ky ujë i jepet të sëmurit për ta pirë, për t'u larë me të, ose hidhet mbi të sëmurin. Forma tjetër është që pasi të lexohet çdo ajet dhe sure nga këto që janë dhënë, të fryhet me cifla të padukshme pështyme në pëllëmbë dhe me to të fërkohet gjymtyra e sëmurë apo i gjithë trupi i të sëmurit (me kusht që personi ta bëj vetë këtë për veten e tij ose për familjarin e tij që ia lejon Islami).

10. Kush e bën Rukjen duhet të jetë musliman, teksa rukja mund t'i bëhet edhe jomuslimanit.

11. Këndimi i duave të mëposhtme për vete ose një tjetër, bëhet duke pasur parasysh shënimet përkatëse lidhur me to.

Së dyti: Rukje-kurim me Kuran

Ajetet dhe suret e mëposhtme i sëmuri i këndon vetë nëse është i rritur, por nëse është i vogël, atij ia këndon prindi, vëllai, motra etj., që e marrin atë pranë dhe këndojnë mbi të sa vijon (siç u cek më sipër, këndimi mund të bëhet njëkohësisht edhe mbi ujë, nga i cili i sëmuri pi dhe lahet):

(I) El-Fatihaja

Arabisht:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ * الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ * الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ * مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ * إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ * اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ * صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ

Transliterimi (surja me shkronja latine):

BISMIL-LAAHIR-RAĦMAANIR-RAĦIIM!
EL ĦAMDU LIL-LAAHI RAB-BIL ĂALEMIIN.
ER-RAĦMAANIR-RAĦIIM. MAALIKI JEUMID-DIIN.
IJ-JAAKE NEĂBUDU UE IJ-JAAKE NESTEĬIN.
IHDINAŠ-ŠIRAAŤAL MUSTEĶIIM.
ŠIRAAŤAL-LEDHIINE ENĂMTE ĂLEJHIM,
GAJRIL MAGĎUUBI ĂLEJHIM UE LEĎ-ĎAAAAL-LIIN.

Kuptimi shqip:

“Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!
Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.
Mëshiruesit, Mëshirëbërësit.
Sunduesit të ditës së gjykimit.
Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.
Udhëzona në rrugën e drejtë!
Në rrugën e atyre që i bekove me të mira,
jo në të atyre që je i hidhëruar me ta dhe as të atyre që kanë humbur vetveten!”

(II) Ajetul Kursij (El-Bekare: 255)

Arabisht:

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ لَا تَأْخُذُهُ سِنَةٌ وَلَا نَوْمٌ لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ

Transliterimi (ajeti me shkronja latine):

ALL-LLAAHU LAA ILAAHE IL-LAA HUEL-ĬHAJ-JUL-ĶAJ-JUUM.

LA TEË-KHUDHUHU SINETU-UE LAA NEUM.

LEHUU MAA FIS-SEMAA-UAATI UE MAA FIL-ERĎ.

MEN DHEL-LEDHII JESHFEŬ ĬNDEHU, IL-LAA BI IDHINIH.

JEĂLEMU MAA BEJNE EJDIIHIM UE MAA KHALFEHUM, UE LAA JUĬHIĬTUUNE BI SHEJ-IM-MIN ĬLMIHI IL-LAA BIMAA SHAA-Ë.

UESIĂ KURSIJ-JUHUS-SEMAA-UAATI UEL ERĎA, UE LAA JEUUDUHU ĬHIFĎĬHUHUMAA UE HUEL-ĂLIJ-JUL-ĂĎĬHIIM.

Kuptimi shqip:

“Allahu, e askush nuk meriton të adhurohet, përveç Tij.

Ai është i përjetshmi, Ai që furnizon dhe mbron gjithçka që ekziston.

Atë nuk e kap as dremitja, as gjumi.

Atij i përket çfarëdo që është në qiej dhe në tokë.

Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai pa lejen e Tij?!

Ai e di çfarë u ndodh atyre (krijesave në këtë botë) dhe çfarë do të ndodhë pas tyre (në Botën Tjetër).

Ata kurrë s'do të mund të nxënë ndonjë gjë nga dija e Tij, përveç asaj çfarë Ai do.

Kursi-a e Tij shtrihet mbi qiejt dhe tokën, dhe Ai nuk ndjen lodhje në kujdesin ndaj tyre. Ai është më i larti, më i madhi.”

(III) Dy ajetet e fundit të sures El-Bekare (285-286)

Arabisht:

آمَنَ الرَّسُولُ بِمَا أُنْزِلَ إِلَيْهِ مِنْ رَبِّهِ وَالْمُؤْمِنُونَ كُلٌّ آمَنَ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِنْ رُسُلِهِ وَقَالُوا سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا غُفْرَانَكَ رَبَّنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ * لَا يُكَلِّفُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا لَهَا مَا كَسَبَتْ وَعَلَيْهَا مَا اكْتَسَبَتْ رَبَّنَا لَا تُؤَاخِذْنَا إِنْ نَسِينَا أَوْ أَخْطَأْنَا رَبَّنَا وَلَا تَحْمِلْ عَلَيْنَا إِصْرًا كَمَا حَمَلْتَهُ عَلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِنَا رَبَّنَا وَلَا تُحَمِّلْنَا مَا لَا طَاقَةَ لَنَا بِهِ وَاعْفُ عَنَّا وَاغْفِرْ لَنَا وَارْحَمْنَا أَنْتَ مَوْلَانَا فَانْصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ

Transliterimi (ajetet me shkronja latine):

EEMENER-RESUULU BIMAA UNZILE ILEJHI MIN RAB-BIHI UEL MUËMINUUN,

KUL-LUN EEMENE BIL-LAAHI UE MELAAIKETIHI UE KUTUBIHI UR RUSULIH,

LAA NUFER-RIĬKU BEJNE EĬHADIM-MIR-RUSULIH,

UE ĬKAALUU SEMIĂNEE UE EŤAĂNEE GUFRAANEKE RAB-BENEE UE ILEJKEL MAŠIIR.

LAA JUKEL-LIFULL-LLAAHU NEFSEN IL-LEE USĂHAA, LEHAA MAA KESEBET UE ĂLEJHAA MAKTESEBET,

RAB-BENEE LAA TUEEKHIDHNEE IN NESIJNEE EU EKHŤAĂNEE,

RAB-BENEE UELAA TEĬHMIL ĂLEJNEE IŠRAN KEMAA ĬHAMELTEHU ĂLEL-LEDHIINE MIN ĬKABLINEE,

RAB-BENEE UELAA TUĬHAM-MILNEE MAA LAA ŤAAĬKATE LENEE BIH,

UEĂFU ĂN-NEE UEGFIR LENEE, UERĬHAMNEE ENTE MEULAANEE, FENŠURNEE ĂLEL ĬKAUMIL KEEFIRIIN.

Kuptimi shqip:

"I Dërguari beson në atë (Kuranin) që i është shpallur nga Zoti i tij e po ashtu dhe besimtarët: të gjithë besojnë në Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të dërguarit e Tij (duke thënë): "Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij". Ata thonë: "Ne dëgjojmë dhe bindemi. Faljen Tënde kërkojmë, o Zoti Ynë dhe te Ti do të kthehemi!" Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka: në dobi të tij është e mira që bën, kurse në dëm të tij është e keqja që punon. Zoti ynë, mos na ndëshko për atë që harrojmë ose veprojmë pa qëllim! Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë, ashtu si i ngarkove ata para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me diçka që nuk mund ta bartim! Na i shlyej gjynahet tona, na i fal ato dhe na mëshiro! Ti je Zoti Ynë! Prandaj na jep fitore kundër atyre që nuk besojnë!"

(IV) Leximi i ajeteve në vijim

a. Në rastin e mësyshit:

● El-Kalem: 51

Arabisht:

وَإِنْ يَكَادُ الَّذِينَ كَفَرُوا لَيُزْلِقُونَكَ بِأَبْصَارِهِمْ لَمَّا سَمِعُوا الذِّكْرَ وَيَقُولُونَ إِنَّهُ لَمَجْنُونٌ

Transliterimi (ajeti me shkronja latine):

UE IJ-JEKEEDUL-LEDHIINE KEFERUU LEJUZLIǏUUNEKE BI EBËŠAARIHIM LEM-MEE SEMIǓDH-DHIKRA UE JEǏUULUUNE IN-NEHU LEMEXHËNUUN.

Kuptimi shqip:

“Kur dëgjojnë kujtesën (Kuranin), mohuesit sa nuk të hanë me shikimet e tyre dhe thonë: “Ai është vërtet i marrë!”

b. Në rastin e magjisë:

● El-Araf: 118-121

Arabisht:

فَوَقَعَ الْحَقُّ وَبَطَلَ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ * فَغُلِبُوا هُنَالِكَ وَانقَلَبُوا صَاغِرِينَ * وَأُلْقِيَ السَّحَرَةُ سَاجِدِينَ * قَالُوا آمَنَّا بِرَبِّ الْعَالَمِينَ

Transliterimi (ajetet me shkronja latine):

FEUEǏAǍL-ǏHAǏ-ǏKU UE BAǓALE MAA KEENUU JEǍMELUUN. FEGULIBUU HUNEELIKE UENǏALEBUU ŠAAGIRIIN. UE ULǏIJES-SEǏARETU SEEXHIDIIN. ǏAALUU EEMEN-NEE BIRAB-BIL ǍALEMIIN.

Kuptimi shqip:

“Në këtë mënyrë, doli në shesh e vërteta dhe dështoi ajo që kishin bërë ata. Kështu, Faraoni dhe njerëzit e tij u mundën dhe u kthyen të poshtëruar, kurse magjistarët u përulën në sexhde, duke thënë: ‘Ne besojmë në Zotin e botëve.’”

● Junus: 81-82

Arabisht:

قَالَ مُوسَى مَا جِئْتُمْ بِهِ السِّحْرُ إِنَّ اللَّهَ سَيُبْطِلُهُ إِنَّ اللَّهَ لا يُصْلِحُ عَمَلَ الْمُفْسِدِينَ * وَيُحِقُّ اللَّهُ الْحَقَّ بِكَلِمَاتِهِ وَلَوْ كَرِهَ الْمُجْرِمُونَ

Transliterimi (ajetet me shkronja latine):

ǨAALE MUUSEE MAA XHIËTUM BIHIS-SIǪR,

IN-NELL-LLAAHE SEJUBŤILUH,

IN-NELL-LLAAHE LAA JUŠLIǪU ĂMELEL MUFSIDIIN.

UE JUǪHIǨ-ǨULL-LLAAHUL ǪAǨ-ǨA BIKELIMEETIHI UELEU KERIHEL MUXHRIMUUN.

Kuptimi shqip:

“Musai tha: “Kjo që keni sjellë ju, është magji dhe vërtet, Allahu do ta shkatërrojë atë.

Allahu, me siguri që do ta prishë punën e ngatërrestarëve.

Allahu, me fjalën e Tij e forcon të Vërtetën, edhe sikur ta urrejnë keqbërësit këtë!”

● Ta Ha: 69

Arabisht:

وَلا يُفْلِحُ السَّاحِرُ حَيْثُ أَتَى

Transliterimi (ajeti me shkronja latine):

UE LAA JUFLIǪUS-SEEǪIRU ǪAJTHU ETEE

Kuptimi shqip:

“Magjistari nuk do të ketë sukses kudo që të gjendet.”

● El-Bekare 102-103

Arabisht:

وَاتَّبَعُوا مَا تَتْلُو الشَّيَاطِينُ عَلَى مُلْكِ سُلَيْمَانَ وَمَا كَفَرَ سُلَيْمَانُ وَلَكِنَّ الشَّيَاطِينَ كَفَرُوا يُعَلِّمُونَ النَّاسَ السِّحْرَ وَمَا أُنْزِلَ عَلَى الْمَلَكَيْنِ بِبَابِلَ هَارُوتَ وَمَارُوتَ وَمَا يُعَلِّمَانِ مِنْ أَحَدٍ حَتَّى يَقُولَا إِنَّمَا نَحْنُ فِتْنَةٌ فَلَا تَكْفُرْ فَيَتَعَلَّمُونَ مِنْهُمَا مَا يُفَرِّقُونَ بِهِ بَيْنَ الْمَرْءِ وَزَوْجِهِ وَمَا هُمْ بِضَارِّينَ بِهِ مِنْ أَحَدٍ إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ وَيَتَعَلَّمُونَ مَا يَضُرُّهُمْ وَلَا يَنْفَعُهُمْ وَلَقَدْ عَلِمُوا لَمَنِ اشْتَرَاهُ مَا لَهُ فِي الْآخِرَةِ مِنْ خَلَاقٍ وَلَبِئْسَ مَا شَرَوْا بِهِ أَنْفُسَهُمْ لَوْ كَانُوا يَعْلَمُونَ * وَلَوْ أَنَّهُمْ آمَنُوا وَاتَّقَوْا لَمَثُوبَةٌ مِنْ عِنْدِ اللَّهِ خَيْرٌ لَوْ كَانُوا يَعْلَمُونَ

Transliterimi (ajetet me shkronja latine):

UET-TEBEŬU MAA TETLUUSH-SHEJAAŤIINU ĂLEE MULKI SULEJMAAN,

UE MAA KEFERA SULEJMAANU UELEEKIN-NESH-SHEJAAŤIINE KEFERUU,

JUĂL-LIMUUNEN-NEESES-SIĬHRA UEMAA UNZILE ĂLEL MELEKEJNI BIBAABILE HEERUUTE UE MEERUUT,

UEMAA JUĂL-LIMEENI MIN EĬHADIN ĬHAT-TEE JEĬKUULEE IN-NEMEE NAĬHNU FITNETUN FELAA TEKFUR,

FEJETEĂL-LEMUUNE MINHUMEE MAA JUFER-RIĬKUUNE BIHI BEJNEL MER-I UE ZEUXHIH,

UEMAA HUM BIĎAAAAR-RIINE BIHI MIN EĬHADIN IL-LEE BI IDHNIL-LAAH,

UE JETEĂL-LEMUUNE MAA JEĎUR-RUHUM UELAA JENFEŬHUM,

UELEĬKAD ĂLIMUU LEMENISH-TERAAHU MAA LEHU FIL EEKHIRATI MIN KHALAAĬK,

UE LEBIËSE ME SHERAU BIHI ENFUSEHUM LEU KEENUU JEĂLEMUUN.

UELEU EN-NEHUM EEMENUU UET-TEĬKAU LEMETHUUBETUM-MIN ĬNDIL-LAAHI KHAJR, LEU KEENUU JEĂLEMUUN.

Kuptimi shqip:

“Dhe shkuan pas shpifjeve që bënin djajtë kundër mbretërisë së Sulejmanit.

E Sulejmani nuk ishte mohues, por djajtë ishin mohues.

Ata u mësonin njerëzve magjinë dhe dijeninë që u ishte dërguar dy engjëjve në Babiloni - Harutit e Marutit.

Këta engjëj nuk i mësonin ndokujt magji, pa i thënë: "Ne jemi dërguar për t'ju vënë në provë, andaj ti mos u bëj mohues (duke mësuar apo ushtruar magjinë)!"

Dhe njerëzit mësuan nga këta të dy se si t'i ndajnë bashkëshortët.

Por magjistarët nuk mund t'i bëjnë dëm askujt pa lejen e Allahut.

E megjithatë, njerëzit mësojnë ato gjëra që i dëmtojnë e nuk u bëjnë dobi.

Në të vërtetë, ata e dinin se ai që e përvetësonte këtë mjeshtëri, nuk do të kishte kurrfarë të mire në jetën tjetër.

Eh, sa e keqe është ajo për të cilën shitën shpirtrat e veta!

Ah, sikur ta dinin ata!

Sikur ata të besonin dhe të ruheshin (nga gjynahet), shpërblimi i Allahut do të ishte më i mirë.

Ah, sikur ta dinin ata!"

(V) Ikhlasi (Kul Hue Allahu)

Arabisht:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ * قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ * اللَّهُ الصَّمَدُ * لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ * وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ

Transliterimi (surja me shkronja latine):

BISMIL-LAAHIR-RAĦMAANIR-RAĦIIM!

ĶUL HUELL-LLAAHU EĦAD.

ALL-LLAAHUŠ-ŠAMED. LEM JELID UE LEM JUULED.

UE LEM JEKUL-LEHUU KUFU-UEN EĦAD.

Kuptimi shqip:

"Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Thuaj: ai, Allahu është i Vetmi.

Allahu është Absoluti (i Përjetshmi), të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim.

S'ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i përngjan."

(VI) El-Mau'dheteni (Dy Suret Mbrojtëse):

● El-Felek

Arabisht:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ * قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ * مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ * وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ * وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ * وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ

Transliterimi (surja me shkronja latine):

BISMIL-LAAHIR-RAĬHMAANIR-RAĬHIIM!

ĬKUL EŬUDHU BI RAB-BIL FELEĬK.

MIN SHER-RI MAA KHALEĬK.

UE MIN SHER-RI GAASIĬKIN IDHE UEĬKAB.

UE MIN SHER-RIN-NEF-FEETHEETI FIL ŬĬKAD.

UE MIN SHER-RI ĬHAASIDIN IDHEE ĬHASED.

Kuptimi shqip:

"Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Thuaj: 'I mbështetem Zotit të agimit. Prej dëmit të çdo krijese, që Ai e krijoi. Dhe prej errësirës së natës kur ngryset plotësisht. Dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryjnë nyja. Edhe prej dëmit të smirëkeqit kur sipas smirës vepron.'"

● En-Nas

Arabisht**:**

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ * قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ * مَلِكِ النَّاسِ * إِلَهِ النَّاسِ * مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ * الَّذِي يُوَسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ * مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ

Transliterimi (surja me shkronja latine)**:**

BISMIL-LAAHIR-RAĬHMAANIR-RAĬHIIM!

ĬKUL EŬUDHU BI RAB-BIN-NËËS. MALIKIN-NËËS.

ILAAHIN-NËËS. MIN SHER-RIL

UES-UEESIL KHAN-NËËS.

EL-LEDHII JUES-UISU FI ŠUDUURIN-NËËS.

MINEL XHIN-NETI UEN-NËËS.

Kuptimi shqip:

“Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Thuaj: ‘Mbështetem (mbrohem) me Zotin e njerëzve!

Sunduesin e njerëzve.

Të adhuruarin e njerëzve.

Prej të keqes së cytësit që fshihet.

I cili bën cytje në zemrat e njerëzve.

Qoftë ai (cytësi) nga xhindet ose nga njerëzit.’”

Së treti: Rukje-kurim me Lutje Profetike

Duatë / Lutjet e mëposhtme i sëmuri i këndon vetë nëse është i rritur, por nëse është i vogël, atij ia këndon prindi, vëllai, motra etj., që e marrin atë pranë dhe këndojnë mbi të sa vijon (siç u cek më sipër, këndimi mund të bëhet njëkohësisht edhe mbi ujë, nga i cili i sëmuri pi dhe lahet):

1. Duaja e Parë:

Arabisht:

أُعِيذُكَ بِكَلِمَاتِ اللهِ التَّامَّةِ، مِنْ كُلِّ شَيْطَانٍ وَهَامَّةٍ، وَمِنْ كُلِّ عَيْنٍ لاَمَّةٍ

Transliterimi (duaja me shkronja latine):

UĬIDHUKE BI KELIMEETIL-LAAHIT-TEEM-MEE-TI, MIN KUL-LI SHEJŤAANIN UE HEEM-MEH, UE MIN KUL-LI ĂJNIN LEEM-MEH."

[Kur e lexojmë duanë për vete në vend të "**UĬIDHUKE**", themi: "**EŬUDHU**".]

Kuptimi shqip:

"**Të mbroj** ty përmes fjalëve të plota të Allahut nga çdo shejtan dhe gjallesë e dëmshme dhe nga çdo sy dëmtues."[9]

[Kur e lexojmë duanë për vete në vend të "**Të mbroj ty**" do të themi: "**Mbrohem**".]

2. Duaja e Dytë:

Arabisht:

بِاسْمِ اللهِ أَرْقِيكَ، مِنْ كُلِّ شَيْءٍ يُؤْذِيكَ، مِنْ شَرِّ كُلِّ نَفْسٍ أَوْ عَيْنِ حَاسِدٍ، اللهُ يَشْفِيكَ بِاسْمِ اللهِ أَرْقِيكَ

Transliterimi (duaja me shkronja latine):

BISMIL-LAAHI URĎIIKE, MIN KUL-LI SHEJ-IN JUËDHIIKE, MIN SHER-RI KUL-LI NEFSIN UE ĂJNIN ĎAASIDINI, ALL-LLAHU JESHFIIKE, BISMIL-LAHI ERĎIIKE."

Kuptimi në shqip:

"Me emrin e Allahut të kuroj, të ta largojë çdo gjë që të lëndon, prej të keqes së çdo shpirti dhe syri ziliqar, Allahu të shëron ty, me emrin e Allahut të kuroj."[10]

[Kjo lutje bëhet vetëm për tjetrin.]

[9] Shih: El-Bukhari 3371, Ibn Maxhe 3525 etj.; Albani dhe Shuajb Arnauti kanë thënë se hadithi është "sahih / i saktë".
[10] Muslimi 2186.

3. Duaja e Tretë:

Arabisht:

اللَّهُمَّ رَبَّ النَّاسِ أَذْهِبِ البَاسَ، اشْفِهِ وَأَنْتَ الشَّافِي، لاَ شِفَاءَ إِلَّا شِفَاؤُكَ، شِفَاءً لاَ يُغَادِرُ سَقَمًا

Transliterimi (duaja me shkronja latine):

ALL-LLAAHUM-ME RAB-BEN-NËËSI,

EDH-HIBIL BEESE, **ISHFIHI,** UE ENTESH-SHAAFI,

LA SHIFAAE IL-LAA SHIFAAUK, SHIFAA-EN LAA JUGAADIRU SEǨAMEN.

[Kur e lexojmë duanë për vete në vend të "**ISHFIHI**" themi: "**ISHFINI**".]

Kuptimi shqip:

"O Allahu ynë, Zoti i njerëzve, largoje lëndimin (sëmundjen), **shëroje atë**, Ti je shëruesi, nuk ka shërim veç shërimit Tënd, shërim që nuk le sëmundje pas."[11]

[Kur e lexojmë për vete në vend të "**shëroje atë**" themi: "**shëromë mua**".]

4. Duaja e Katërt:

Arabisht:

أُعِيذُكَ بِكلِماتِ الله التَّاماتِ من شرّ ما خَلَقَ

Transliterimi (duaja me shkronja latine):

"**UǏIDHUKE** BI KELIMEETIL-LAAHIT-TEEM-MEETI, MIN SHER-RI MAA KHALAǨ."

[Kur e lexojmë duanë për vete në vend të "**UǏIDHUKE**" do të themi: "**EǓUDHU** ".]

Kuptimi shqip:

"**Të mbroj ty** përmes fjalëve të plota të Allahut nga e keqja **(**sherri) i gjithçkaje që Ai ka krijuar."[12]

[Kur e lexojmë për vete në vend të "**Të mbroj ty**" do të themi: "**Mbrohem**".]

5. Duaja e Pestë:

Arabisht:

أُعِيذُكَ بِكَلِمَاتِ اللهِ التَّامَّاتِ مِنْ غَضَبِهِ، وَعِقَابِهِ، وَشَرِّ عِبَادِهِ، وَمِنْ هَمَزَاتِ الشَّيَاطِينِ، وَأَنْ يَحْضُرُونِ

[11] Bukhari 5743.
[12] Muslimi 2708, Ebu Daudi 3455 etj.

Transliterimi (duaja me shkronja latine):

"**UĬIDHUKE** BI KELIMEETIL-LAAHIT-TEE-MEETI, MIN GAĎABIHI, UE ĬĶAABIHI, UE SHER-RI ĬBAADIHI, UE MIN HEMEZEETISH-SHEJAAŤIINI, UE EN JEĦĎURUUN."

[Kur e lexojmë duanë për vete në vend të "**UĬIDHUKE**" do të themi: "**EŬUDHU**"].

Kuptimi shqip:

"**Të mbroj ty** përmes fjalëve të plota të Allahut, nga zemërimi i Tij, nga ndëshkimi i Tij, nga ligësia e robërve të Tij, nga ngacmimet e djajve dhe që ata të të afrohen."[13]

[Kur e lexojmë për vete në vend të "**Të mbroj ty**" themi: "**Mbrohem**".]

6. Duaja e Gjashtë:

Arabisht:

بِسْمِ اللَّهِ يُبْرِيكَ وَمِنْ كُلِّ دَاءٍ يَشْفِيكَ وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ وَشَرِّ كُلِّ ذِي عَيْنٍ

Transliterimi (duaja me shkronja latine):

BISMIL-LAAHI JUBRIIKE, UE MIN KUL-LI DEE-IN JESHFIIKE, UE MIN SHER-RI ĦAASIDIN IDHEE ĦASED, UE SHER-RI KUL-LI DHII ĂJN.

Kuptimi shqip:

"Me emrin e Allahut, Ai të shëron, të shëron nga çdo sëmundje, edhe nga e keqja e smirëziut kur të smiron, edhe nga e keqja e çdo mësyshmarrësi."[14]

[Kjo lutje bëhet vetëm për tjetrin.]

7. Duaja e Shtatë:

Arabisht:

أَسْأَلُ اللَّهَ الْعَظِيمَ رَبَّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ أَنْ يَشْفِيَكَ

Transliterimi (duaja me shkronja latine):

ES-ELULL-LLAAHEL-ĂĎĦIIM RAB-BEL ĂRSHIL-ĂĎĦIIM EN JESHFIJEK.

[E lexojmë shtatë herë.]

Kuptimi shqip:

"E lus Allahu e Madhërishëm, Zotin e Arshit Madhështor, të të shërojë!"[15]

[Kjo lutje bëhet vetëm për tjetrin.]

[13] Shih: Et-Tirmidhi 3528 etj.; Albani ka thënë se hadithi është "sahih / i vërtetë".
[14] Muslim 2185.
[15] Ebu Daudi 3106, Albani dhe Shuajb Arnauti kanë thënë se hadithi është "sahih/ i vërtetë".

Prezantim i shkurtër me autorin:

Altin Torba lindi me 09.07.1975 në Bulqizë dhe po aty përfundoi Shkollën e Mesme të Përgjithshme (1989-1993). Më pas, kreu 2 vjet studime në Institutin Teologjik Islam "Ebu Hanife" (1994-1996) po në Bulqizë. U diplomua në Universitetin "El-Iman", profili "Teologji Islame", në Sana të Jemenit (1997-2001) dhe pak vite më vonë u diplomua në Fakultetin e Shkencave Sociale, profili "Edukatë Qytetare", në Universitetin 'Aleksandër Xhuvani", në Elbasan (2004-2009).

Njeh në nivelin "shumë mirë" arabishten; ka punuar kryesisht në fushën e thirrjes islame si mësues i teologjisë dhe ligjërues xhamie në Shqipëri dhe jashtë saj.

Gjithashtu, ka një qasje të ngushtë me literaturën islame në lëmin e përpilimit, sidomos në atë të përkthimit. Në këtë kuadër, është autor i një sërë përpilimesh të përkthyera, por edhe autoriale, të botuara në një sërë revistash si: "Drita Islame", "Familja", "Etika", "Vepra" etj.

Sa i përket lëmit të përkthimit, është autor i një vargu përkthimesh për një kohë relativisht të gjatë, fillimisht për faqen elektronike "Ikra" dhe më pas për portalet elektronikë "Ardhmëriaonline" dhe "ProfetiMuhamed.info".

Nga viti 2018 është anëtar i stafit të përkthyesve shqiptarë të portalit të njohur "IslamHouse.com". Ndërsa në fushën e botimit të librit islam është angazhuar si përkthyes për një sërë librash të botuar nga disa shtëpi botuese, si: "Mesazhi", "Furkan ISM", etj.

Në periudhën 2011-2013 ka pasur një angazhim radiofonik në Radio Kontakt, ku ka drejtuar emisione të formatit fetar dhe social.

Po kështu, është përgjegjës i faqes "Jeta e Vërtetë – Pyetje-Përgjigje Fetare Islame (facebook)" dhe portalit teologjik islam "http://jetaever8.de (Jeta e Vërtetë)".

Nga viti 2011-të shërben në faltoren "Ikra" si imam për muslimanët shqiptarë të qytetit Siegen në Gjermani dhe prej vitit 2015 është anëtar i Komisionit të Fetvave pranë Unionit të Bashkësive Islame Shqiptare në Gjermani (UBISHGJ).

Allahu i shpërbleftë të gjitha ata që i luten Zotit për mbarësi dhe lumturi familjare të përdybotshme për autorin e këtij përpilimi dhe mbarë muslimanët!